

LIGJI
PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PER QEVERINE E
REPUBLIKES SE MAQEDONISE

Neni 1

Ne Ligjin per Qeverine e Republikes se Maqedonise ("Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" nr. 59/2000 dhe 12/2003), ne nenin 39, paragrafet (2) dhe (3) ndryshojne si vijon:

„(2) Sa i perket Sekretariatit te Pergjithshem, Sekretari i Pergjithshem i ka te drejtat dhe detyrimet e funksionarit i cili drejton me organin e administrates shteterore, kurse puna e tij percaktohet me Rregullore.

(3) Per punen e vet dhe per punimet e Sekretariatit te Pergjithshem, Sekretari i Pergjithshem pergjigjet para Kryeministrit dhe para Qeverise.“

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

“(4) Sekretarit te Pergjithshem te Qeverise, Qeveria i emeron zevendes.“

Neni 2

Pas nenit 40, shtohen dy nene te reja 40-a dhe 40-b, si vijojne:

“Neni 40-a

(1) Themelohet Sekretariati i Pergjithshem si sherbim profesional i Qeverise.

(2) Sekretariati i Pergjithshem siguron bashkerenditje dhe perkrahje profesionale per nevojat e Qeverise, Kryeministrit, zevendesve te tij, si edhe per nevojat e anetareve te Qeverise ne realizimin e kompetencave te tyre; realizon bashkepunim dhe bashkerenditje me ministrite dhe me organet e tjera te administrates shteterore si edhe per ceshtjet me prioritet strategjik te Qeverise dhe ne vecanti per realizimin e Marreveshjes Kornize, bashkerendit propozimin, miratimin dhe percjelljen e realizimit te Programit vjetor per punimet e Qeverise; i siguron informatat e domosdoshme dhe keshillat e mendimet profesionale ne lidhje me krijimin dhe analizen e politikave te Qeverise; ne menyre operative e percjell dhe e njofton Qeverine per realizimin e konkluzioneve te Qeverise; siguron pergatitje efikase dhe mbajtjen e seancave te Qeverise dhe te trupave punues prane Qeverise, siguron informata per publikun; i bashkerendit aktivitetet qe kane te bejne me realizimin e reformes ne administraten publike, realizon bashkepunim profesional me Sherbimin profesional te Kuvendit te Republikes se Maqedonise, te Presidentit te Republikes se Maqedonise dhe me sherbimet profesionale te organeve te tjera te pushtetit shteteror, si edhe me organizata joqeveritare dhe me subjekte te tjera juridike; e realizon procesin e menaxhimit te punimeve, kryen edhe pune te tjera profesionale dhe logjistike te percaktuara me Rregullore, si edhe pune te tjera te cilat do t'i percaktoje kryeministri dhe Qeveria.

Neni 40-b

(1) Per kryerjen e puneve qe kane te bejne me ceshtjet evropiane dhe me sigurimin e bashkerenditjes te organeve te administrates shteterore dhe organeve e institucioneve te tjera, si edhe per kryerjen e puneve te tjera profesionale nga kjo fushe, themelohet Sekretariati per Ceshtje Evropiane.

(2) Sekretariati per Ceshtje Evropiane i kryen punet qe kane te bejne me: sigurimin e bashkerenditjes dhe harmonizimit te punes te organeve te administrates shteterore dhe organeve e institucioneve te tjera, per perгатitjen e Republikes se Maqedonise per aderim ne Unionin Evropian, perfshire edhe negociatat per aderimin tone ne Unionin Evropian; sigurimin e bashkerenditjes se aktiviteve per realizimin e Marreveshjes per stabilizim-asocim te lidhur ndermjet Republikes se Maqedonise dhe Bashkesive Evropiane dhe shteteve te tyre anetare dhe marreveshjeve te tjera te lidhura ndermjet Republikes se Maqedonise dhe Unionit Evropian, si edhe te trupave punues te themeluara ne kuader te marreveshjes se lidhur dhe marreveshjeve te tjera me Unionin Evropian; sigurimin e bashkerenditjes te procesit te perгатitjes se versionit te Maqedonise “acquis communautaire” (E drejta e Unionit Evropian); sigurimin e bashkerenditjes per shkak te harmonizimit te punimeve te perfaqesuesve te Republikes se Maqedonise ne institucionet dhe trupat punues te Unionit Evropian; sigurimin e bashkerenditjes per shkak te harmonizimit te punimeve te Republikes se Maqedonise si shtet anetar i Unionit Evropian; sigurimin e bashkerenditjes se asistences nga jashte, nga ana e Unionit Evropian dhe shteteve anetare te saj dhe asistences tjeter nga jashte ne lidhje me reformat komplementare te procesit te integritimit te Republikes se Maqedonise ne Unionin Evropian; informimin e publikut me aktivitetet e nderlidhura me procesin e integritimit evropian dhe ceshtjeve evropiane; si edhe me pune te tjera te nderlidhura me Unionin Evropian te cilat do t’i percaktoje Qeveria.

(3) Sekretariatin per Ceshtje Evropiane e drejton anetari i Qeverise i ngarkuar per ceshtje evropiane i cili i ka te drejtat dhe detyrimet e funksionarit i cili drejton me nje organ te administrates shteterore."

Neni 3

Ne nenin 41, paragrafi (1) ndryshon si vijon:

“(1) Per nevojat e veta Qeveria mund te themeloje edhe sherbime te tjera te pavarura apo sherbime te perbashketa profesionale dhe sherbime te tjera.”

Neni 4

Ne nenin 42, pas fjaleve: “Sekretariati Ligjvenes”, shtohen fjalet: “Sekretariati i Pergjithshem, Sekretariati per Ceshtje Evropiane”, kurse ne fund te fjalise pika zevendesohet me presje dhe shtohen fjalet: “ne qofte se me kete ligj nuk eshte percaktuar ndryshe”.

Neni 5

Qeveria me kete ligj do t’i harmonizojte aktet qe kane te bejne me Sekretariatin e Pergjithshem si sherbim profesional, brenda afatit prej 30 ditesh, nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Neni 6

Sekretariati i Pergjithshem dhe Sekretariati per Ceshtje Evropiane, aktet e reja per organizimin dhe sistematizimin te vendeve te punes ne perputhje me kete ligj, do t'i nxjerrin brenda nje afati prej 30 ditesh, nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Neni 7

Punonjesit, pajisjen, inventarin, dokumentacionin dhe mjetet e punes te Sektorit per Integrim Evropian prane Sekretariatit te Pergjithshem, i ndermerr Sekretariati per Ceshtje Evropiane.

Neni 8

Ky ligj hyn ne fuqi dite e tete nga dita e shpalljes ne "Gazeten zyrtare te Republikes se Maqedonise".